

VENDIM
Nr.198, datë 16.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.634, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS DHE
BALETIT E ANSAMBLIT POPULLOR, TË OBJEKTIT NR.19 “GODINA E
SINOPTIKËS SË VJETËR”, PJESË E PRONËS NR.109 “ISH-UZINA E ARTILERISË”,
ME VENDNDODHJE, BRARË, TIRANË, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË
MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.634, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit, fjalët “... nr.19 “Godinë e Sinoptikës së Vjetër”...” zëvendësohen me “... me sipërfaqe 1031.63 m²... ”.

2. Në pikën 1 fjalët “... nr.19 “Godinë e Sinoptikës së Vjetër”, me sipërfaqe 980.4 (nëntëqind e tetëdhjetë pikë katër) m²...” zëvendësohen me “... me sipërfaqe 1031.63 (një mijë e tridhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e tre) m², sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha